



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 19.06.2013

Nr. 0204-767

PËR: Avni Kastrati, Kryetar i Komunës së Mitrovicës
Rrustem Musa, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës

**LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS
SË MITROVICËS, Nr. 02/06 - 12453/5 Pranuar me datë, 13.06.2013**

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-04, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Nr. 02/06 - 12453/5, të miratuar me datë 30.05.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi Nr. 02/06 - 12453/5, të gjitha trotuaret nëpër qytet janë në shërbim të këmbësorëve, nuk mund të përdoren për parkim të automjeteve.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana: 19.06.2013

Br. 0204-767

Za: Avni Kastrati, Gradonačelnik Opštine Mitrovica
Rrustem Musa, Predsedavajući Skupštine Opštine Mitrovica

**PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE OPŠTINE
MITROVICA, Br. 02/06 - 12453/5 Primjeno dana, 13.06.2013**

Poštovani-e

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu za lokalnu samoupravu Br. 03/L-04, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva posle razmatranja Odluke Br. 02/06 - 12453/5, usvojene dana 30.05.2013, **POTVRDJUJE** zakonitost ovog akta i ceni da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu .

Pravni akt naveden u nastavku,ima puni pravni efekat .

- Odluka br. 0. 02/06 - 12453-5 svi trotuari u gradu su u službi pešaka, ne mogu se koristit za parkiranje vozila.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamanikpremijera i Ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Rukovodiocima Uprava MALS-a
Arhivi MALS-a.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica - Municipality of Mitrovica



KUVENDI I KOMUNËS
Nr. 02/06 - 12453/5 dt. 30.05.2013
Mitrovicë

02-06-12453/5
30.05.2013

Bazuar në nenin 12 paragrafi 2 pika d të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale; nenin 2 paragrafi 7 pika f të Ligjit për sigurinë në komunikacion Nr. 02/L-70 (GZ. Nr. 36 dt. 25.08.2008); nenin 6 pika b të Ligjit për transportin rrugor Nr. 2004/01 dhe Ligji Nr. 08/L-127 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2004/1 (GZ. Nr. 35 dt. 11.08.2008); neni 5 paragrafi 2, neni 8 paragrafi 1, neni 13 paragrafi 1 dhe neni 22 paragrafi 2 të Ligjit për rrugët Nr. 2003/11 (GZ. Nr. 16 dt. 01.09.2007) dhe Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët Nr. 2003/11 (GZ. Nr. 46 dt. 15.01.2009); nenin 23 paragrafi 2 pika d të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 30.05.2013 në lidhje me Konkluzionin e Kuvendit të Komunës Nr. 02/06-9536/3 dt. 25.04.2013 dhe Propozimin e Kryetarit të Komunës për miratim të Planit për rregullimin e komunikacionit në rrugën "Mbretëresha Teutë", rrugën "Shemsi Ahmeti" dhe bulevardin "Isa Boletini"; si dhe caktimin e parkingjeve publike, sjellë këtë:

VENDIM

1. Të gjitha trotuarët në qytet pa përjashtim janë në shërbim të këmbësorëve dhe nuk mund të përdoren për parkim të automjeteve.
2. Të gjitha parkingjet, për të cilat Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë ka leshuar vendime për shfrytëzimin e sipërfaqes publike për subjektet e caktuara të qytetit, mbesin në fuqi. Vendimet mund të ndryshohen varësisht prej planit të ri të parkimit.
3. Parkimi në rrugën "Mbretëresha Teutë" dhe rrugët që lidhen me këtë rrugë, organizohet si më poshtë:
 - 3.1 Ndalohet parkimi i automjeteve në 4 (katër) korsitë e segmentit të rrugës prej parkut "Fehmi dhe Xhevd Lladrovci" deri te kryqëzimi me rrugën "Beteja e Kosharës".
 - 3.2 Segmenti prej rrugës "Beteja e Kosharës" deri tek rruga "Lekë Dukagjini" - lejohej parkimi në korsinë e djathtë nga të dy anët e rrugës, përjashtim bëhe hapësira 10 m pas vendndalimit të këmbësorëve.
 - 3.3 Segmenti prej rrugës "Lekë Dukagjini" deri tek kryqëzimi me rrugën "Konstantin Kristoforidhi" - ndalohet parkimi nga të dy anët e rrugës.
 - 3.4 Nga kryqëzimi i rrugës me rrugën "Konstantin Kristoforidhi", deri 30 m para kryqëzimit me rrugët "Jeton Tërstena" dhe "Ukshin Kovaqica" - lejohej parkimi në të dy anët e rrugës.
 - 3.5 Segmenti i rrugës nga kryqëzimi me rrugën "Ukshin Kovaqica" deri te kryqëzimi me rrugën "Sali Çeku" - ndalohet parkimi në të dy anët e rrugës.
 - 3.6 Prej kryqëzimit me rrugën "Jeton Tërstena" deri në hyrje të auto-parkingut publik të Komunës - ndalohet parkimi i të gjitha automjeteve në të gjitha korsitë e rrugës.
 - 3.7 Nga hyrja e auto-parkingut të Komunës deri 30 m para kryqëzimit të rrugës me bulevardin "Isa Boletini" - lejohej parkimi në korsi të djathtë në të dy anët e rrugës, përjashtim bëhe 10 m para dhe 10 m pas vendkalimit të këmbësorëve.

- 3.8 Në tërësi ndalohet parkimi në të dy anët e rrugëve: "Bedri Gjina", "Komajl Ataturku", "Adem Voca" - vetëm deri tek Stadiumi "Fatime Xhaka", "Hasan Prishtina", "Martirët e Kombit", "Ahmet Selaci" dhe "Afrim Zhitia".
4. Parkimi në rrugën "Shemsi Ahmeti" dhe rrugët që lidhen me këtë rrugë, organizohet si më poshtë:
- 4.1 Segmenti i rrugës prej rrethrotullimit deri tek kryqëzimi me rrugën "Hasan Prishtina" - rezervohet vetëm për operatorë taxi dhe për autotaxi individual.
 - 4.2 Segmenti i rrugës prej kryqëzimit me rrugën "Hasan Prishtina" deri tek sheshi "Skënderbeu" - ndalohet parkimi i automjeteve.
 - 4.3 Segmenti i rrugës nga kryqëzimi me rrugën "Agim Ramadani-Katana" deri 30 m para kryqëzimit me rrugën "Bislim Bajgora" - lejohet parkimi në korsitë e djathta të rrugëve, përveç vendkalimit të këmbësorëve 10 m para dhe 10 m pas.
 - 4.4 Segmenti i rrugës nga kryqëzimi me rrugën "Bislim Bajgora" deri tek kryqëzimi me rrugën "Esat Mehollit", - ndalohet parkimi i automjeteve në të dy anët e rrugëve.
 - 4.5 Segmenti i rrugës nga kryqëzimi me rrugën "Esat Mehollit" deri tek objekti i fakultetit, - lejohet parkimi i automjeteve në të dy anët e rrugës, përveç kryqëzimit.
5. Me qëllim të sigurimit të qarkullimit të lirë, Komuna ka këto parkingje publike:
- 5.1 Parkingu në Stacionin e Autobusëve;
 - 5.2 Parkingu në hapësirën e Ish "Des-it";
 - 5.3 Parkingu në sipërfaqet publike prapa ndërtesave të ish "Ramiz Sadikut";
 - 5.4 Parkingu afër Muzeut të qytetit;
 - 5.5 Parkingu i qytetit (ish garazhat e "Kosovatransit");
 - 5.6 Parkingu para Palestrës së Sporteve;
 - 5.7 Parkingu në hapësirën e Ish Bashkësisë Lokale - përball Shoqatës së gjuetarëve;
 - 5.8 Parkingu në rrugën "Xhafer Deva".
6. Parkingjet publike të cekura në pikën 5 të këtij vendimi, me përjashtim të pikës 5.6 - Parkingu para Palestrës së Sporteve, e cila mbetet e lirë për shfrytëzim, i ipen në shfrytëzim N.P. "Stacioni i Autobusëve", deri më dt. 31.12.2013.
7. 60% e të hyrave që krijohen nga këto parkingje i ndahen N.P. "Stacioni i Autobusëve", ndërsa 40% buxhetit të Komunës.
8. Me qëllim të funksionalizimit të parkingjeve sipas pikës 5.2 - Parkingu në hapësirën e Ish "Des-it" dhe 5.7 Parkingu në hapësirën e Ish Bashkësisë Lokale - përball Shoqatës së gjuetarëve, obligohet Drejtoria e Inspektionit të bëjë rënimin e objekteve, që e pengojnë funksionalizimin e parkingjeve.
9. Ky vendim hyn në fuqi ditën e publikimit në ueb faqen e Komunës.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kurvendit


Dr. Rrustem MUSA

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesuesit të Kurvendit
1 x 1 MAPI
1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës
Të gjitha drejtorive